



**Prishtinë: 18.07.2012**

**Kodi i ZRRE-së: V\_424\_2012**

**Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_768\_04\_12**

### **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreut IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_768\_04\_12**; dhe
5. Ankesën e KEK-ut me datë 08.05.2012.

**Në mbledhjen e mbajtur më 18 korrik 2012 nxorri këtë:**

### **VENDIM**

- I **REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin Orhan Gota (shifra në KEK: DPZ - 144951), nga Prizren, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_768\_04\_12 i datës 24.04.2012.

### **Arsyetim**

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut pas kërkesës së konsumatorit me datë 12.10.2010 kanë dalur te konsumatori dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik nr. 7450732 duhet të dërgohet në kalibrim sepse xhami i njehsorit është i hapur (ana e majtë).

Pas kësaj punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 7450732 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 47444872.

Pas ndërrimit të njehsorit elektrik nga punëtorët e autorizuar të KEK-ut dhe dërgimit në qendrën e kalibrimit punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 7450732, ku është konstatuar se njehsori elektrik është pa blloba shtetërore, nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka, përreth qelqit nga ana e poshtme është futur shiriti filmik dhe ka pluhur të shiritit filmik.

Me datë 25.11.2009 Departamenti i Faturimit në KEK e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPZ11HP06126 në vlerë prej 270.88€.

Pas ngarkesës së KEK-ut për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike në vlerë prej 270.88€, konsumatori ka parashtruar ankesë në KEK. Departamenti për konsumator në KEK ka shqyrtuar lëndën e konsumatorit ku edhe ka refuzuar ankesën e tij. Konsumatori pas marrjes së përgjigjë përgjigjës nga ana e KEK-ut, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me të cilin ka kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.



Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 24.04.2012 ka nxjerr vendim duke **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të shkarkoj konsumatorin nga fatura e shfrytëzimit të paautorizuar (rikthimit të humbjeve) DPZ11HP06126 e datës 28.03.2011 në vlerë prej 270.88€.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 08.05.2012 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, me të cilën ka kundërshtuar pjeshëm vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_768\_04\_12 të datës 24.04.2012, dhe njëherit ka propozuar që aprovohet kundërshtimi i KEK-ut dhe borxhi i theksuar më sipër të ngelet kontest deri në përfundimin e të gjitha procedurave ligjore.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 18 korrik 2012 ka analizuar dëshmitë e paraqitur nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit procesverbalin e kalibrimit.

Gjatë analizës së lëndës së konsumatorit Bordi ka vërejtur se ka mos përputhje mes konstatimeve të procesverbaleve të KEK-ut atyre të kontrollës dhe atyre të kalibrimit si dhe vërtetimit të ndërrimit të njehsorit elektrik, ngase në procesverbalin e KEK-ut nr. 0557888 të datës 12.10.2010 punëtorët e autorizuar të kontrollës kanë konstatuar se njehsori elektrik nr. 7450732 duhet të dërgohet në qendrën e kalibrimit pasi xhami është i hapur nga ana e majtë, ndërsa në vërtetimin e ndërrimit të njehsorit elektrik dhe procesverbalin e kalibrimit nuk është theksuar se xhami i njehsorit është i hapur, madje në procesverbalin e kalibrimit theksohet se nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe shpenzimin e energjisë elektrike me njehsor të vjetër dhe me njehsor të ri ka ndryshim, nga me njehsor të ri ka rënie të shpenzimit të energjisë elektrike. Mesatarja e shpenzimit me njehsorin e vjetër nr. 7450732 prej periudhës 08/2002 – 11/2010 ka qenë 622 kWh/muaj, ndërsa me njehsorin e ri nr. 47444872 prej periudhës 11/2010 – 12/2011 është 446 kWh/muaj.

Po ashtu janë analizuar edhe listat e leximit të KEK-ut, ku është vërejtur se lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se njehsori elektrik i konsumatorit është në rregull si dhe ka edhe vulën distributive në rregull, që do të thotë se lexuesi i KEK-ut nuk ka evidentuar asnjë parregullsi në pikën matëse.

Sa i përket kundërshtimit të KEK-ut në ankesë që të merret bazë vetëm procesverbali i kalibrimit për të anuluar pjesërisht vendimin e DMK-së, Bordi i ZRRE-së pas shqyrtimit të këtij procesverbali ka vlerësuar se konstatimet e bëra në procesverbalin e kalibrimit nuk kanë qenë bindëse për të vërtetuar atë çka është theksuar në procesverbal. Sipas nenit 8, paragrafi 8.3 i Procedurës për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë elektrike theksohet se, konstatimet e parregullsisë funksionale të njehsorit elektrik të konstatuara në laboratorin e kalibrimit nuk mund të përdoren si provë e vetme meritore për ngarkimin e konsumatorit me faturën e rikthimit të energjisë së humbur.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 18.07.2012 ka analizuar ankesën e KEK-ut dhe vendimin e nxjerrë nga ana e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_768\_04\_12, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur në diapozitivin e këtij vendimi.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar